



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0965

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani- Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.”, kundër njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e DDD në hapsirat e burgjeve për DSHB” me numër të prokurimit 206-23-11154-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Ministria e Shëndetësisë”, më 15/02/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e “Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.” me nr. 2023/0965, e datës 01/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e DDD në hapsirat e burgjeve për DSHB”, me numër të prokurimit 206-23-11154-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Ministria e Shëndetësisë”.
2. Për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e DDD në hapsirat e burgjeve për DSHB”, me numër të prokurimit 206-23-11154-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Ministria e Shëndetësisë”. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga ekspertit shqyrtues të mbështetura nga Paneli Shqyrtues.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.10.2023, “Ministria e Shëndetësisë”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Shërbimet e DDD në hapsirat e burgjeve për DSHB”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbimë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 439,000.00 €.

Me 20.11.2023, OE “Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit të lartcekur të AK. Me 27.11.2023, Autoriteti Kontraktues e ka pranuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 01/12/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.” me nr. 965/23 lidhur me aktivitetin “Shërbimet e DDD në hapsirat e burgjeve për DSHB” me numër të prokurimit 206-23-11154-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet e OE ankues: “Në pajtim me të gjitha dispozitat ligjore për konkurim në tender publik, kompania “DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D”. SH.P.K., dëshiron të aplikoj në tenderin me titull: Shërbimet e DDD në hapësirat e burgjeve për DSHB” me nr. prokurimi: 206-23- 11154-21-2-1-1“. Afati i fundit për dorëzim të tenderëve është dt.08.12.2023 në ora 13:00, po ashtu afati i njëjti për hapjen e tenderëve dt. 08.12.2023 në ora 13:00, afat ky i shtyer sipas njoftimit të dt.29.11.2023.

Autoriteti Kontraktues, duke vendosur në kërkesën për rishqyrtim të OE-së, duke e aprovuar pjesërisht sipas vendimit të dt.27.11.2023, kurse përmes kësaj ankese atakohet pjesët e vendimit të cilat nuk janë ndryshuar sipas kërkesës për rishqyrtim të dt.20.11.2023, lidhur me dosjen e tenderit të publikuar me 13.10.2023 dhe sqarimeve shtesë të dhëna si dhe njoftimit të publikuar me dt.29.11.2023, por që gabim i ka mbetur prapë data 13.10.2023, kurse AK Ministria e Shëndetësisë e publikon formularin standard për korrigjimin e gabimeve dt.29.11.2023, i njëjti nuk është në përputhje me vendimin e AK dt.27.11.2023, për aktivitetin e Prokurorit “Shërbimet e DDD në hapësirat e burgjeve për DSHB” me nr. prokurimi: 206-23-11154-21-2-1-1“

Vendimi i dt. 27.11.2023 nga AK “Ministria e Shëndetësisë” – Departamenti i Prokurorit i cili mbështet vazhdimin e procesit të prokurimit me nr:prokurimi: 206-23-11154-21-2-1- 1, sa i përket tenderit për “ Shërbimet e DDD në hapësirat e burgjeve për DSHB“, është proces jo i rregullt për shkak se është marr në shkelje të dispozitave ligjore si më poshtë:

Neni 1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 5 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 6 Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 17 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 27 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Në vazhdim paraqiten pretendimet e përgjithshme të procesit të tenderimit që konsiderojmë se nuk janë respektuar nga AK, të cilat do ti listojmë si në vijim:

Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1 par. 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Prokurim Publik. Ashtu që neni 3 par.1 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se “Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla”, e që AK, në mënyrë direkte i shkelë të trija paragrafet e nenit 1 të LPP-së, me rastin e përgatitjes së një specifikacioni të tillë në dosjen e tenderit, për shkak se edhe pas vendimit të dt.27.11.2023, ka bërë përmirësime disa prej tyre të

nevojshme e disa që kanë qenë të domosdoshme nuk i ka bërë, të cilat do të listohen në vijim.

Fillimisht mos paraqitja e kërkesë sonë për rishqyrtim e dt.20.11.2023, në e-prokurim, është tendencioze nga AK, po vetëm është paraqitur kërkesa e OE Lan Group me dt.24.11.2023, paraqet shkelje dhe është e qëllimshme, për shkak se del në pah mosaftësia e komisionit që e ka përgatitur dosjen e tenderit, si dhe ndikimi dhe marrja pjesë direkt e OE (OE-ve), bashkë me zyrtarin përgjegjës të burgjeve në Ministrinë e Shendetësisë duke vendosur kritere dhe specifikë e teknike, favorizuese dhe diskriminuese.

Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par.1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente” lidhur me par. 2 të njëjtit nen dhe ligj ceket se “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik”, në rastin se kur janë parashtruar pyetjet lidhur me atë se tek Kapaciteti teknik dhe profesional, Kërkesa 2, keni kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një përshkrim të mënyrës së kryerjes së shërbimeve me detal për implementimin sipas fazave, i cili përshkrim duhet të paraqes metodat për mënyrën e zbatimit të punëve pa ndryshuar rutinat e burgut përfshirë edhe planin dinamik. Kurse në përgjigjen e AK, ka të bëjë vetëm me atë se duhet të ruhet rendi shtepiak, si dhe punëtorët që punojnë duhet të kenë të kaluar të pastër kriminale, por që në fakt kjo nuk ka të bëjë fare me këtë sepse për tu kryer këto shërbime se paku dy orë në hapësirën që trajtohet nuk duhet të ketë kontakt njeriu, e që kjo mund të arrihet me lëvizjen e pjesëshme të dënuarve dhe personelit zyrtar, sepse sipas rendit shtepiak, çdo ditë të dënuarit kanë të drejtë në dy orë të drejtë daljeje në ambiente të jashtme, e që në këtë mënyrë kryhet trajtimi pa penguar dhe ndryshuar rendin shtepiak, dhe kjo duhet të jetë gjithmonë në përputhje me menaxherin e kontratës i cili duhet ta bëjë planin dinamik. Kurse sa i përketë emalit të bashkëngjitur në vegzën e sqarimeve shtesë, i njëjti vetëm sqarohen se këto hapësira duhet të dezinfektohen vetëm në rast se i dënuari është i infektuar, atëherë bëhet dezinfektimi, kurse informata tjera lidhur me DDD, nuk ka apo mungojnë. Kurse arsyetimi i AK, në vendimin e dt.27.11.2023 se DDD duhet bërë pa lëvizjen e të burgosurve duke arsyetuar se në qendrat e paraburgimit që janë 6 të tilla as që lejohet të dalin dhe të takohen në mes vete, në qoftë se OE paraprak e ka bërë një gjë të tillë, pra ka kryer shërbimet e DDD pa lëvizjen e të burgosurve e njëjta gjë mund të bëhet edhe nga ne por që përgjegjësia iu bie juve si AK për mos lejimin e lëvizjes së tyre konform planit detal të menaxherit të kontratës. Kurse sa i përket të punësuarve dhe të kaluarës së tyre kriminale që është rregull e SHKK, normalisht që nuk kërkohet ndryshimi i këtyre rregullave, kjo çështje nuk mund të ndryshohet sipas pretendimit tuaj pasi që është çështje e sigurisë dhe ka funksionuar që nga viti 2010 pa vështirësi nga OE paraprak, e në këtë rast lind një pyetje e thjeshtë se që nga viti 2010 vetëm një OE i njëjtë paska kryer shërbimet e DDD në këtë institucion e kjo është një shkelje flagrante e parimit të konkurrencës për arsye se në qoftë se një OE paraprak i ka kryer këto shërbime tash e 13 vite atëherë i bie që komplet kjo dosje e tenderit qenka përgatitur për këtë OE e që kjo në mënyrë automatike është diskriminuese për OE tjera dhe favorizuese për OE paraprake. Po ashtu duhet të cekur se për të pasur një dezinfektim profesional në hapësira të

brendshme banuesit se paku nga 15 min deri në 30 min, duhet të largohen në rastin e kryerjes së shërbimit, për shkak se nëse nuk largohen atëherë mund të ketë reaksione alergjike dhe pengesa në frymmemarrje, pengesa në shikim-sy, nga i njëjti, ashtu që dezinfektimi i vetëm profesional për këtë hapësira me përgjegjësi të plotë është vetëm me ULV Elektrostatike, ku bëhet shpërndarja uniforme e dezinficientit në gjithë hapësirën e trajtuar, andaj AK duhet pasur parasysh shëndetin e banueseve gjithmonë duke e ruajtur kualitetin e trajtimit profesional.

Për me tepër kërkesa që OE të ketë së paku një kontratë për hapësira të brenshme ku DDD, është kryer pa levizjen e banuesve, pa zbrazjen e hapësirave gjatë procesit është e pa pranueshme, kundërligjore, favorizuese, jo profesionale, diskriminuese për shkak se është para përgatitur për një OE të caktuar, dhe si kërkesë e tillë duhet hequr gjithsesi nga dosja e këtij tenderi.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur edhe nenin 9 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t’i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtësore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikimin e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues” andaj vlerësojmë se AK ka bërë shkelje të këtij nenit me rastin e mos-harmonizimit të kërkesave në terren dhe specifikimit të dosjes së tenderit tek Kapaciteti teknik dhe profesional, Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe paisje teknike qe janë të domosdoshme për realizimin projektit a. Minimum 2 gjenerator motorik Ultra Low Volume me kapacitet se paku 100 Litra. B. Minimum 2 makina POWER sprayer me kapacitet 300 litra c. Minimum 8 pomp low volume (këto pompa low volume nuk guxojnë të përdoren në hapësira të brenshme) d. Minimum 2 vetura per vendosjen e gjeneratoreve (pickup).

Në kërkesën e parë për rishqyrtim janë paraqitur pyetjet dhe vërjetje lidhur me këto specifika të lartcekura, disa prej të cilave janë zvogëluar por që përsëri si në vendimin e AK-së datë 27.11.2023 dhe në informatat shtesë nuk janë dhënë sqarime për këto zvogëlime dhe as vërejtjeve tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të datës 20.11.2023 për arsye se Kërkesa për gjenerator ULV , me kapacitet se paku 100 litra, është favorizuese dhe diskriminuese për OE, i cili posedon këto paisje me këtë kapacitet të caktuar në dosjen e tenderit.

Me 1 ULV, sipas përvojës sonë me kapacitet 50 litra, brenda 2 orëve kryhet dezinfektim hapësiror i 100 hektarëve, kurse në bazë të çmimoreve të dosjes së tenderit konstatohet se hapësira e jashtme në total për të gjitha burgjet është 90.88 hektar, kështu që nuk është e nevojshme me qenë kapaciteti 100 litra dhe nuk është e nevojshme me qenë as dy ULV, për arsye se me një gjenerator ULV kryhet dezinfektimi brenda dy orëve i 100 ha, por janë rreth 90.88 ha, për më tepër janë 8 pompa low volume që nuk janë përcaktuar lloji i tyre se a janë elektrike apo motorike, por nëse janë motorike nuk guxojnë të përdoren në hapësirë të brendshme por vetëm jashtë, e që në informatat e fundit shtesë nuk është specifikuar lloji i tyre. Kjo specifikë është diskriminuese për OE tjera dhe favorizuese për OE paraprak për shkak se nuk ka nevojë për këtë kapacitet të kërkuar. Kurse me pyetjen se pse duhet të jenë 2 POWER SPRAYER në kapacitet 300 litra, kur mund të kryhet me një POWER SPRAYER të kapacitetit më të vogël (300 litra), plus duke shtuar se janë 8 pompa motorike low volume të krahut, e në të vërtetë këto POWER SPRAYER, duhet të hiqet krejt nga dosja e tenderit për shkak se me këto bëhet kontaminimi i thellë i tokës dhe mundësia e rrezikshmërisë ndaj banorëve të burgjeve dhe stafit zyrtar rritet. AK në vendimin e saj të datës 27.11.2023 në faqen 3 i ka ulur disa specifika të kërkuara, por nuk ka arsyetuar pretendimet tona të ngritura në kërkesën për rishqyrtim për arsye se nuk i ka marrë parasysh sqarimet e ofruara lidhur me kontaminimin e thellë të tokës e që për AK duhet të ishte shqetësuese një gjë e tillë. Andaj edhe kjo kërkesë për këto paisje është favorizuese dhe diskriminuese për OE, i cili posedon këto paisje me këtë kapacitet të caktuar në dosjen e tenderit.

Shkelja e radhës nga Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 1 dhe nenit 7 të Ligjit të prokurimit me rastin e përgatitjes së një dosje të tenderit diskriminues dhe favorizues, tek kapaciteti Teknik dhe profesional, Kërkesa 4, OE duhet të ofrojë dëshmi për stafin profesional dhe atë si në vijim: a) një epidemiolog b) një agronom c) dy teknikë sanitarë me license valide d) së paku 10 (dhjetë) punëtorë të punësuar gjatë vitit, në tri vitet e fundit.

Në kërkesën për rishqyrtim të datës 20.11.2023 kemi kërkuar sqarime pse duhet të ketë agronom, pse duhet të jenë së paku dy teknikë sanitarë e jo teknikë të DDD-së dhe pse duhet të jenë 10 punëtorë të punësuar gjatë vitit, në tri vitet e fundit, sa i përket sqarimit për punëtorë vetëm është bërë një riformulim i fjalisë kurse kuptimi i saj ka mbetur i njëjtë sikur se të kërkohej 10 punëtorë përgjatë një viti për tri vitet e fundit është një lloj sikurse kërkesa fillestare në dosjen e tenderit për 30 punëtorë në tri vitet e fundit.

E kjo si kërkesë është kërkesa më diskriminuese e këtij tenderi dhe sipas LPP-së, kjo është e ndaluar por AK, nuk e ka pasur parasysh këtë gjë.

AK nuk ka jepur sqarimet e duhura se pse duhet të ketë teknikë sanitarë e sidomos agronom për shkak se në përgjigjen e dhënë Lidhur me stafin, është bërë kërkesa për staf të përshtatshëm për natyrën e punës që pritet të bëhet në këtë institucion ku ka edhe banim, edhe vend punim, edhe pjesë bujqësore, serra, puse të ujit, ferma etj., që përfshihet një ekosistem i tërë që nevojiten: agronomi përgjegjës për pjesën bujqësore dhe kujdesin për mjedisin, bimët, shtazët dhe njerëzit, (Këtu duhet bërë një dallim esencial sepse agronomi është për pjesën bujqësore, mund të participojë për kujdesin e mjedisit, por jo për kafshë, e kurrsesi për njerëz, sepse është

epidemiologu), epidemiologu për punët e tjera profesionale lidhur shërbimet parandaluese, planifikuese me DDD, (Epidemiologu e ka rolin esencial në përformancën e shërbimeve të DDD, dhe repelimit e gjarpërinjëve si dhe dezinfektimit hapësinor), ndërsa teknikët sanitar janë profesionistët e vetëm adekuat për këtë veprimtari, ku ka licencë nga Institucionet e Arsimit të Lartë të akredituar në Kosovë si teknik sanitar si dhe licencë punë nga MSh për këtë shërbim. Ne nuk kemi njohuri që ka shkollim adekuat dhe licencë pune për profesion të DDD-së, në vend. Sa i takon çështjes së numrit të punëtorëve, po ashtu është sqaruar në publikim para se ju ta bënit këtë shkresë, kështu që AK, fillimisht sa i përketë Agronimit, Burgjet duhet të ketë agronomin e vetë të punësuar për nevojat e veta dhe i njëjti nuk është i nevojshëm për shkak se agronimi i prezentuar në dosje e ka kohën e shkurtuar të qëndrimit në institucion si dhe ai nuk është i kualifikuar të mirret me puset e ujit, dhe nuk është kualifikuar të jep vlerësim në ekosistem dhe nevojat që kërkohen, kështu që duhet të hiqet agronomi se nuk ka kurfarë roli në këtë tender, kurse për tekniket sanitar është i mjaftueshëm të jetë vetëm një teknik sanitar dhe jo dy të tillë, kurse AK lidhur me kërkesën për heqjen e agronimit nuk ka dhënë asnjë arsyetim.

Po ashtu AK, ka dhënë përgjigje në atë se “teknikët sanitar janë profesionistët e vetëm adekuat për këtë veprimtari, ku ka licencë nga Institucionet e Arsimit të Lartë të akredituar në Kosovë si teknik sanitar si dhe licencë punë nga MSh për këtë shërbim”, mirëpo kjo është gabim sepse teknikët sanitar nuk i licencon Ministria e Shëndetësisë por Oda e Infermierëve të Kosovës. Dhe kjo tregon se AK, nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme lidhur me përgatitjen e dosjes së tenderit si tërësi. Arsyetimi që jep AK, për shkollimin adekuat Teknik i DDD, është jo profesional dhe diskriminuese për shkak se nuk ju jep mundësi teknikëve të DDD, të cilët janë të certifikuar jashtë vendit të kenë mundësi të barabartë me teknikët sanitar. Sa i përketë numrit të punëtorëve e njëjta ka mbetur e njëjtë vetëm është thënë se 10 punëtorë brenda një viti, për tri vitet e kaluara e që është e njëjta çështje. E që përsëri kjo është favorizuese dhe diskriminuese për OE të caktuar.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 1 dhe nenit 7 të Ligjit të prokurimit me rastin e përgatitjes së një dosje të tenderit diskriminues dhe favorizues. Lidhur me atë se sipas pyetjeve të parashtruara tek specifikime Teknike të detyrueshme, tek publikimi i datës 29.11.2023 për informata shtesë, pika B: DDD duhet të bëhet me preparate në vijim:

Preparatet që duhen të përdoren për DDD:

1. Dezinfektues: (didecyldimethy lammonium chloride 3.4gr ose të ngjajshme)
2. Deratizues: (brodifacoum 0.005%; bromadiolon 0.005%), ose të ngjashme nga prodhues të ndryshëm por këto dy substanca.
3. Dezinjektues (Bifenthrin 9.7; Fipronil 0.01%; Imidacloprid 10%, ose permethrine 30 %, pyperonil butoxide 30 % ose të ngjashme nga prodhues të ndryshëm por këto tri substanca.
4. Largimi i zvarranikeve (Cinnamon Oil), ose vajra të ngjashme për këtë qëllim.

Na sqaroni se pse te dezinfektuesit keni kërkuar preparate te ngjajshme, ndërsa për deratizim, dezinfektim dhe repelim te zvarranikëve nuk keni kërkuar preparate të ngjajshme po vetëm preparatet e prezentuara?

Kurse AK më vendimin e saj është përgjigjur se preparatet janë ekologjike dhe kanë qenë në kontratën paraprake kështu që janë bërë ndryshime lidhur me numrin e preparateve të njëjtat nga prodhues të ndryshëm por me përmbajtje të njëjtë. Nuk ka marrë parasysh shqetësimet e ngritura në faqen 7 të kërkesës për rishqyrtim të datës 20.11.2023 si më poshtë:

Sa i përket Bifenthrin 9.7, si preparat dezinfektues është i njohur se vështirë tretet në ujë, ka veprim rezidual të gjatë deri në 4 muaj, për këtë paraqet rrezik për njerëz dhe kafshë dhe gjithashtu gjatë të reshurave nëse trajtohet me të në thellësi të tokës atëherë mundet të i kontaminojë ujërat nëntokësor e me këtë të bëjë edhe helmimin e gjallesave ujore, njerëzve dhe kafshëve, për më tepër Bifenthrin 9.7, është toksik për bletë dhe të gjitha insektet polenizuese, toksik për peshqit dhe gjallesat tjera, mund të shkaktoj dëm në shëndetin e të dënuarve, personelit zyrtar, duke shkaktuar probleme respiratore dhe të sistemit nervor, po ashtu sipas EPA (Agjencioni për Mbrojtjen e Ambientit) konsiderohet si preparat kancerogjen i mundshëm njerëzor Kategoria C. Po ashtu Bifenthrin 9.7, nuk lejohet të përdoret me ULV dhe fogim të nxehtë, do të thotë se është i ndaluar për dezinfektim hapësinor për insektet fluturuese. Kurse në dosjen e tenderit nuk paraqitet asnjë preparat konform që mund të përdoret për dezinfektim hapësinor – Mushkonjave dhe mizave. E në anën tjetër kemi shumë preparate të cilat janë shumë më pak toksike dhe me efikase se sa Bifenthrin 9.7.

Kur AK, ka bërë përmirësimin apo korigjimin e gabimeve përmes njoftimit të dt.29.11.2023, sa i përket 1. Dezinfektues: (didecyldimethy lammonium chloride 3.4gr ose te ngjajshme), në të njëjtën mënyrë nuk ka vepruar me preteparatet tjera pasi që ka lënë mundësi që 2. Deratizues: (brodifacoum 0.005%; bromadiolon 0.005%), ose të ngjashme nga prodhues të ndryshëm por këto dy substanca. (për këtë nuk është dashur të shenohet nga prodhues të ndryshëm për këto dy substanca por është dashur të shenohet vetëm të ngjashme apo ekuivalente si të dezinfektuesit).

3. Dezinfektues (Bifenthrin 9.7; Fipronil 0.01%; Imidacloprid 10%, ose permethrine 30 %, pyperonil butoxide 30 % ose të ngjashme nga prodhues të ndryshëm por këto tri substanca. (për këtë nuk është dashur të shenohet nga prodhues të ndryshëm për këto tri substanca por është dashur të shenohet vetëm të ngjashme apo ekuivalente si të dezinfektuesit).

4. Largimi i zvarranikeve (Cinnamon Oil), ose vajra të ngjashme për këtë qëllim. (për këtë nuk është dashur të shenohet nga vajra të ngjashme për këtë qëllim por është dashur të shenohet vetëm të ngjashme apo ekuivalente me preparatin e kërkuar).

Në pikën tre tek dezinfektuesit shtohet preparati: permethrine 30 %, pyperonil butoxide 30 %, që shihet se është drejtëpërsdrejti i ndikuar nga një OE e caktuar, se edhe për këtë nuk janë tri substanca por janë katër substanca. Edhe për këto preparate permethrine 30 %, pyperonil butoxide 30 %, duhet të ngjashme apo ekuivalente.

Kërkojmë që të lejohet fjala EKUVALENTE, dhe po ashtu të përdoret që preparatet e prezantuara të kenë leje përkatëse nga MMPHI.

AK lidhur me pretendimet e poshtë shënuara sikur në kërkesën për rishqyrtim të datës 20.11.2023 fare nuk është lëshuar në këto pretendime në vendimin e saj, pra të njëjtat vetëm i ka injoruar e kjo në kundërshtim me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, andaj në këtë kërkesë i përsërisim pretendimet e njëjta për shkak të rëndësisë së tyre: AK, ka bërë shkelje të radhës të LPP-së, Tek Specifikimet teknike të detyrueshme pika 2. DEZINSEKTIMI, DERATIZIMI DHE PARANDALIM I ZHVILLIMIT TE GJARPINJVE NE HAPESIRAT E JASHTME TE BURGJEVE.

Pika 1. (Trajtimi duhet të bëhet në thellësi të tokës në sipërfaqe dhe në ajër në muajt nga marsi deri në tetor).

Pika 2. (Aparatura e cila do të përdoret për këte aktivitet duhet të jetë e përshtatshme duke pasur parasysh ndjeshmërinë e aktiviteteve që ndërmerren e që njëherë duhet ruajtur ekuilibrat biologjik - ekologjike si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.)

Na Sqaroni me këto preparate dhe aparature të kërkuar, si mund të bëhet dezinfektimi hapësinor për mushkonja dhe miza dhe si mund të trajtohet në thellësi të tokës dhe në sipërfaqe e duke i ruajtur ekuilibrat biologjik dhe ekologjik?

Kurse AK, ka dhënë përgjigje se “Ne kemi bërë kërkesën tonë për këto shërbime dhe kemi kërkuar specifikat e kryerjes së tyre, zbatimit në përpikëri në periudhën kohore, vendet sipas specifikave hapësinore, preparateve të kërkuara, duke mbrojtur ekuilibrin biologjik dhe ekologjik, ndërsa OE duhet të na tregojë se si do ta bëjë këtë, prandaj edhe keni për të zhvilluar planin dhe projektin e kryerjes së punëve të kërkuar për të realizuar qëllimin për shërbime cilësore të cilat do të inspektohen nga komisioni profesional dhe inspektorati sanitar përmes monitorimit dhe mostrimit gjatë dhe pas çdo shërbimi. Prandaj kërkesa mbetet e njëjte”, AK nuk e ka të qartë se duke ditur rrezikun e trajtimit me Bifenthrin 9.7, me dy POWER SPRAYER, nuk ruhet ekuilibri ekologjik por vetëm rrezikohet dhe bëhet ndotja e thellë e mjedisit, kështu që preparati Bifenthrin 9.7, duhet të hiqet krejtësisht nga dosja e tenderit dhe dy POWER SPRAYER, të hiqen krejtësisht.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, provat e bashkëngjitura, dispozitat e shkelura ligjore, kërkesat e dosjes së tenderit konstatohet në mënyrë të pakontestueshme se OE Ankues ka të drejtë lidhur me pretendimet e ngritura, që të gjitha këto pretendime në një analizë të mirëfillt të provave dhe bazës ligjore dëshmojnë shkeljet e bëra nga AK dhe domosdoshmerinë e anulimit të pjesërishtë të vendimit të AK.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin Neni 1, 5 pika 1.1, 6, 7, 9, 17, 27, dhe 28 të LPP-Së.

Përgjigja e AK ne ndaj kërkesës për rishqyrtim: "Operatori ekonomik DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D SH.P.K., me date 19.11.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e DDD në hapsirat e burgjeve për DSHB" me nr. të Prok: 206-23-11154-2-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë

27.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Nenet: 1, 5, 6, 7, 9, 17, 27 dhe 28 te LPP-së

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

pergjigja e AK ne lidhie me pretendimet Ankimore të OE "DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D".

Pretendimi 1: Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin I par. 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Prokurim Publik. Ashtu që neni 3 par.1 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personal, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë mefondet dhe/ose burimet e tilla", AK, në mënyrë direkte i shkelë të tria paragrafet e nenit 1 të LPP-së, mc rastin e përgatitjes së një specifikacioni të tillë në dosjen e tenderit.

Përgjigja: Neni 1 (Qëllimi) — sipas këtij neni AK është i obliguar që të siguroj mënyrën më eflkase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Edhe pse nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite, AK ju njofton se ka publikuar Njoftimin për kontrate duke shfrytëzuar procedurën e hapur me qellim te sigurimit ne mënyrën me efikase me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike dhe konfirmon se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim janë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë

Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par. 1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhejodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente" lidhur me par. 2 të njëjtit nen dhe ligj ceket se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve

ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më dhume operatoreve ekonomik", e që AK, në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore sa i përket Kapacitetit Teknik dhe Profesional tek vlera e kontratave 600.000 €, e pse duhet të ketë kontratë për hapësira të brendshme ku DDD, është kryer pa lëvizje të banueseve, kurse përgjigja e AK, lidhur me këto pyetje dhe informata shtesë cek se "Çështja e shumës së Kërkuar është e rregulluar me ligj", kurse sa i përket lidhur me kontratat për DDD brenda dhe jashtë janë ndarë të dhëna si në sqarime shtesë, por që në fakt AK, vetëm ka injo111ar në pyetjet e dhëna sepse kur thuhet se çështja e shumës së kërkuar është e rregulluar me ligj, atëherë me cilin ligj, me cilën dispozitë, kurse sa i përket se çështja e lidhur me kontratat për DDD brenda dhe jashtë janë ndarë të dhëna si në sqarime shtesë, kurse me dt. 13.10,2023 është publikuar Noftimi për Informata Shtesë ose Përmirësim i Gabimit", por që në këtë njoftim nuk jepet ndonjë sqarim lidhur me këtë, e në këtë mënyrë AK po diskriminon OE, tjera duke i favorizuar OE, të caktuara apo OE të mëparshme që kanë kryer veprimet e njëjta në objektin e njëjtë dhe kjo është kundërligjore. (Tek vlera e kontratës kërkojmë që vlera e kontratave të jetë nga 200.000 deri në 400.000 euro, për shkak se në këtë mënyrë jepen mundësi edhe operatorëve tjerë ekonomik, dhe jo vetëm një operatori që ka vlerën e kontratës 600000 euro). AK, në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore sa i përket Kapacitetit Teknik (111e Profesional tek vlera e kontratave 600.000 C,

Përgjigja: Shuma ka qenë më pak se 1.5 herë e shumës sëparaparë të shërbimit, bazuar në çmimin e kontratës paraprake. Kjo është e rregulluar me nenin 68, paragrafi 1 të LPP Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Nëfunksion të mundësimit të pjesëmarrjes së sa me shumë ofertuesve, pretendimi ankimor merret si i bazuar dhe kërkesa do të përmirësohet përmes Formularit standard për korrigjim të gabimeve.

AK do ta zvogëloj vlerën e referencave nga 600, 000.00 në 400,000.00 euro.

Pretendimi 3: Autoriteti Kontraktues ka shkelur përsëri nenin 7 të LPP-së, në rastin se kur janë parashtruar pyetjet lidhur me atë se tek Kapaciteti teknik dhe profesional, Kërkesa 2, keni kërkuar që Operator Ekonomik duhet të dorëzoj një përshkrim të mënyrës së kryerjes së shërbimeve me detal për implementimin sipas fazave, i cili përshkrim duhet të paraqes metodat për mënyrën e zbatimit të punëve pa ndryshuar rutinat e burgut përfshirë edhe Planin dinamik. Kurse në përgjigjen e AK, ka të bëjë vetëm me atë se duhet të ruhet rendi shtëpiak, si dhe punëtorët që punojnë duhet të kenë të kaluar të pastër kriminale, por që në fakt kjo nuk ka të bëjë fare me këtë sepse për tu kryer këto shërbime se paku dy orë në hapësirën që trajtohet nuk duhet të ketë kontakt njeriu, e që kjo mund të arrihet me lëvizjen e pjesshme të dënuarve dhe personelit zyrtar, sepse sipas rendit shtëpiak, çdo ditë të dënuarit kanë të drejtë në dy orë të drejtë daljeje në ambiente të jashtme, e që në këtë mënyrë kryhet trajtimi pa penguar dhe ndryshuar rendin shtëpiak dhe kjo duhet të jetë gjithmonë në përputhje me menaxherin e kontratës i cili duhet ta bëjë Planin dinamik.

Përgjigia: DDD duhet të bëhetpa lëvizjen e banuesve. Shëtitja jashtë bëhet për qëllime të tiera dhe jo të githë të burgosurit mund të dalin në të njëjtën kohë, ndërsa në qendra të paraburgimit, që janë gjashtë sosh, as që lejohet të dalin dhe të takohen në mes vete Sa i takon të punësuarve dhe e kaluara e tyre është kërkesë dhe rregull e ShKK që të verifikohet paraprakisht se kush mund të hyjë e kushjo, janë rregulla që nuk mund të ndryshohen.

Kjo çështje nuk mund të ndryshohet, është çështje e sigurisë dhe kafunksionuar kështu që nga viti/ 2010 pa veshtirësi nga OE paraprak.

Pretendimi 4: Autoriteti Kontraktues ka shkëlur edhe nenin 9 par. I të LPP-së, përcaktohet se "Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistronen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) Iloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh Jti e parashikuar, Iloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjalë tërë afati/ të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (Vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikimin e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsytet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues" andaj vlerësojmë se AK ka bërë shkëlje të këtij nenit me rastin e mos-harmonizimit të kërkesave në terren dhe specifikimit të dosjes së tenderit tek Kapaciteti teknik dhe profesional, Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe paisje teknike qe janë të domosdoshme për realizimin projektit a. Minimum 3 gjenerator motorik Ultra Low Volume me kapacitet se paku 10 Litra. B. Minimum 2 makina power sprayer me kapacitet SOO litra c. Minimum 10 pomp low volume d. Minimum 3 vetura për vendosjen e gjeneratoreve (pickup).

Përgjigia: Në funksion të mundësisimit të pjesëmarrjes së sa më shumë ofertuesve, pretendimi ankimor merret si i bazuar dhe kërkesa do të përmirësohet përmes formularit standard për korrigjim të gabimeve.

Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit:

- a. Minimum d} (2) Gjenerator motorik Ultra Low Volume (UIN) me kapacitet se pakll 100 litra.
- b. Minimum d) (2) makinë Power Sprayer me kapacitet 300 litra
- c. Minimum tetë (8) pompa Low Volume (LV).

d Minimum (2) vetura për -vendosjen e gjeneratorëve (Pick UP)

Pretendimi 5: Shkelja e radhës nga Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit I dhe nenit 7 të Ligjit të prokurimit me rastin e përgatitjes së një dosje të tenderit diskriminues dhe favorizues, tek kapaciteti Teknik dhe profesional, Kërkesa 4, OE duhet të ofrojë deshmi për stafin profesional dhe atë si në vijim: a) një epidemiolog b) një agronom c) (1) teknik sanitar me licencë valide d) së paku 30 (tridhjetë) punëtorë të punësuar gjatë tri viteve të fundit.

a) Na sqaroni se pse duhet të ketë agronom?

b) Na sqaroni pse duhet të jenë së paku dy teknik sanitar e jo teknik të DDD-së?

c) Na sqaroni pse duhet të jenë 30 punëtorë të punësuar gjatë 3 viteve të fundit?

Pergjigjia: Në funksion të mundesimit të pjesëmarrjes së sa më shumë ofertuesëve, pretendimi ankimor merret si i bazuar dhe kërkesa do të përmirësohet përmes Formularit standard për korrigjim të gabimeve.

a. Një (1) epidemiolog me licencë valide

b. Një (1) agronom

c. Dy (2) teknik sanitarë, me licencë valide

d. së paku 10 punëtorë të punësuar për gjatë vitit në tri viteve të fundit.

deshmitë për stafin janë CV-a, Kopja e Diplomës kopja e Licencës, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt,

Lidhur me stafin është bërë kërkesë për stafe të përshtatshme për natyrën e punës që pritet të bëhet në këto institucione ku ka edhe banim, edhe vend punim, edhe pjesë bujqësore, serra, puse të llojit, ferma etj që përfshihen në ekosistemin e tërë që nevojitet: agronomi përgjegjës për pjesën bujqësore dhe kujdesin për mjedisin, bimët, shtazët dhe njerëzit, epidemiologu për punët e tjera profesionale lidhur shërbimet parandaluese, planifikuese me DDD, ndërsa teknikët sanitarë janë profesionistët e vetëm adekuat për këtë veprimtari, ku ka licencë nga Institucionet e Arsimit të Lartë të akredituar në Kosovë si teknik sanitar si dhe licencë pune nga MSH nga profesionet e rregulluara për këto shërbime të cilat fillimisht licencohen nga MSH dhe pastaj ri licencohen nga OIK. Ne nuk kemi njohuri që ka shkollim adekuat dhe licencë punë për profesion të DDD-së në vend. Në rast se ka profesionistët të DDD-së të shkolluar jashtë vendit dhe atë kanë bërë nostrifikim të diplomës e cila është ekuivalente me kompetencat për DDD të teknikeve sanitar nuk ka asnjë pengesë dhe nuk është çështje. Secila diplomë e notifikuar ose barasvlerësuar me atë të teknikut sanitar nga NARIC është e vlefshme.

Pretendimi 6: Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit I dhe nenit 7 të Ligjit të prokurimit me rastin e përgatitjes së një dosje të tenderit diskriminues dhe favorizues. Lidhur me atë se

sipas pyetjeve të parashtruara tek specifikime Teknike te detyrueshmej pika B: DDD duhet të bëhet me preparate në vijim: Preparatet qe duhen të perdoren për DDD:

1, Dezinfektues: (didecyldimethy lammonium chloride 3.4gr ose te ngjajshme)

2. Deratizues: (brodifacoum 0,005%; bromadialon 0.005%)

3, Dezinsektues (Bifenthrin 97; Fipronil 0.01 Yo; imidacloprid 100/0)

4. Largimi i zvarranikeve (Cinnamon Oil)Përgjigja: Preparatet janë ekologjike dhe të njëjtat që kemi qenë në kontratën paraprake, pa ndryshime dhe përpos preparatit për zvarranik të gjithë të tjerët kanë qenë dy e më shumë produkte.

Në dobi të procesit, për të shmangur paqartësitë, preparatet kërkohen si më poslltë, kërkesa do të përmirësohet permes Formularit standard për korrigjim të gabimeve:

1. Dezinfektues: didecyldimethylaninonillil chloride 3.4gr, ose të ngjajshem);

2, Deratizues: (brodifacoum 0,005 0/0 ose broniodialon 01005 0/0); ose të ngjashem nga prodhues të ndryshem per këto dy substanca.

3. Dezinsektues: (Bifenthrill 917 ose Fiproiiil 0.01 Yo ose imidacloprid 1076; ose permetlirine 30 0/01 pyperonil butoxide 30 0/0, ose të ngjashem nga prodhues të ndryslieëm por këto tri substanca.

4. Largimi i zvarranikeve: Cinnamon oil ose vajra të ngjashme per kete qellim;

Pretendimi 7: Për këto hapësira duhen 100 metra gypi lind pyetja kush duhet të vë atë gyp, dhe nëse në këto hapësira të ngushta nuk e zë një person atëherë nuk është i nevojshëm trajtimi fare sepse nuk rrezikohet askush.

Përgjigje: Gjatësia prej 100 metra është e pershtatshme, bazuar ne përvojën e deritaslime, por për të shprehur gatishmeri për mbeshtetje të OE dhe ankesave të tyre, kjo gjatësi nuk dihet të jetë më e shkurter se 50 metra me çka edhe ashtu do të veshtirsohet procesi i punes në "zona sterile" zonat ku nuk mund të kaloj askush por vetem nga distanca behet Dezinfektimi e të cilat janë zona të sigurisë, të rrethuara me tela me gjemba afer rrethojave. Kërkesa do te përmirësohet permes Formularit standard per korrigjim te gabimeve. ”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 07/12/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 965/23, ndërsa me datë 18/12/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0965 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe të korrigjohet dosja e tenderit. AK duhet që gjatë përgatitjes së dosjes

se korrigjuar të përfshijë dhe bartë të gjitha ndryshimet në dosje të tenderit në mënyrë që të mos krijohet konfuzitet në mes të OE të interesuar në aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, “Autoriteti kontraktues nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit. Ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues ”

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K”- Prishtinë eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0965 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr.1 : “Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me mos paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim në platformën e eprokurimit eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja në këtë rast nuk është përgjegjëse sepse është KRPP ajo që e mirëmban sistemin e eprokurimit. Sidoqoftë në sistemin e eprokurimit të butoni “kërkesat për rishqyrtim” është e paraqitur edhe kërkesa për rishqyrtim e OE ankues:

Ndërsa nëse hyn te detajet mund të shihet edhe përgjigja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi nuk është i bazuar.”

Përgjigje në Pretendimin nr.2 : “Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 eksperti shqyrtues sqaron se me dosje të tenderit është kërkuar:

Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet e dorëzojë një përshkrim të mënyrës së kryerjes së shërbimeve me detale për implementimin sipas fazave, i cili përshkrim duhet të paraqesë metodat për mënyrën e zbatimit të punëve pa ndryshuar rutinat e burgut përfshirë edhe planin dinamik.”

Evidenca 2 Përshkrimi i mënyrës së kryerjes së shërbimeve duke përfshirë planin dinamik

OE ankues ka dërguar kërkesë për sqarim me datën 25.10.2023 me të cilën ndër të tjera ka kërkuar sqarime edhe për këtë pikë ku AK është përgjigjur se kërkesa nuk mund të ndryshohet dhe ka rekomanduar që OE-te ta bëjnë përshkrimin në baze të UA Nr. 10/2023 për Rëndin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.

Eksperti shqyrtues gjatë administrimit të provave, dosjes së tenderit, kërkesës dhe përgjigjes në kërkesën për sqarim, vlerëson se AK-ja duhet të veprojë në bazë të nenit 19.4 të RRPP 001/2022 19.4 Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të pa arsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Specifikimet duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Ne specifikimin teknik të bashkangjitur në dosje të tenderit nuk është dhënë një përshkrim i rendit shtëpiak në bazë të të cilit OE-të do të mund të përgatisin përshkrimin e kryerjes së shërbimeve. Duke pas parasysh se për kryerjen e shërbimeve duhet të merret parasysh koha atëherë rekomandimi i AK-së që të shfrytëzohet UA 10/2023 nuk ka të dhëna mjaftueshëm sepse me nenin 22 të UA “Të gjitha aktivitetet ditore përcaktohen dhe zhvillohen sipas rutinës ditore të miratuar nga drejtori i institucioni korrektues”.

Për më tepër pas kontraktimit përpilohet plani i menaxhimit të kontratës që përfshin të gjitha kërkesat e AK-se me rastin e kryerjes së shërbimeve. Poashtu në Aneksin 1 të dosjes së tenderit është përcaktuar se kërkesa 1 paragrafi 3 Kërkesat e rregullat behën sipas kontratës me menaxherin e kontratës, prandaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.3: *“Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 eksperti shqyrtues sqaron se me dosje të tenderit është kërkuar:*

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (lëmin e DDD-së, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 300,000 Euro dhe të ketë së paku një kontratë për hapësira të Brendshme ku DDD është kryer pa lëvizjen e banuesve, pa zbrazjen e hapësirave gjatë procesit, për DD të hapësirave të jashtme dhe largimin e zvarranikëve.,

Evidenca 1 Një listë të kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve.

Sa i perket pretendimit të OE ankues lidhur me kërkesën a) dhe b) eksperti shqyrtues vlerëson se sipas LPP-së neni 69.4.2 mund të kërkojë “tën e të ën a tëso en të g t a o t r a t t e o r e të në h e të h b e e të a u a në p u h n e h u r t e e a r e”

Poashtu bazuar në RRUOPP neni 26.8 për kontratat për shërbime

Në rast të kontratë përofrimin e shërbimeve:

b. Vlera minimale në lidhje me shërbimet në 3 vitet e fundit

b. Një listë që specifikon parimetrelevante të përformancës qëspecifikon: shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin / certifikata e pranimit

Lidhur me kërkesën e tillë KRRP – Departamenti i Monitorimit ka dërguar rekomandim per AK-në me datën 23.10.2023 me te cilin rekomandon riformulimin e kërkesës. Për një rast të ngjashëm janë dhënë edhe opinione nga AKK departamenti per parandalimin e Korrupsionit me nr. 03-03/767/22 të datës 18.02.2022.

Per me tepër kërkesa per numrin e kontratave bie ndesh me nenin 69.4.2 te LPP-se lidhur me nenin 7, dhe nenin 26.8 te RRUOPP prandaj pretendimi në këtë pikë është i bazuar.”

Përgjigje në Pretendimin nr.4: *“Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 eksperti shqyrtues sqaron se me dosje të tenderit është kërkuar:*

Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet të posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektita. Minimum dy (2) Gjenerator motorik Ultra LowVolume (ULV) me kapacitet sëpaku 100 litra.

b. Minimum dy (2) makinë Power Sprayer me kapacitet 300 litra

c. Minimum tetë (8) pompa Low Volume (LV).

d. Minimum dy (2) vetura për vendosjen e gjeneratorëve (Pick UP),

Evidenca 3 Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim

AK ne kërkesën per rishqyrtim te OE ankues te cilën e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar kishte bërë ndryshime ne këtë kërkesë duke zvogëluar kërkesat sipas vendimit.

OE ankues ne këtë pikë përkundër zvogëlimit te kërkesave nga AK-se ka ushtruar të drejtën e ankimit por qe ka dështuar të argumentojë se pse kërkesat e ndryshuara prapë janë diskriminuese.

Sipas LPP_se neni 9 ë c kti i i ne oja e që duhet ë m ush r e përcakton se Autoritet i vetëm ne përcaktimin e nevojave qe duhet përmbushur eshte AK-ja prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se përgjegjësia ekskluzive ne percaktimin e nevojave qe duhet permushur është e AK-së.

OE ankues ka dështuar ta argumentojë se kërkesat jane diskriminuese dhe ne këtë pikë eksperti shqyrtues e sqaron se me dosje të tenderit i është lënë hapësirë edhe OE-ve të interesuar ne aktivitetin e prokurimit qe te dorëzojnë edhe marrëveshje per shfrytëzim.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi në këtë pikë nuk është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 5 : *Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 eksperti shqyrtues sqaron se me dosje të tenderit është kërkuar:*

Kërkesa 4 OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon a.Një (1) epidemiolog melicencë valide b. Një (1)agronom c. Dy (2) tekniksantarë, me licencë valide d. Së paku 10 punëtor të punësuar përgjatë vitit, në tri vitet e fundit.,

Evidenca 4 Për piken a, b dhe c, CV-a, Kopja e Diplomës, Kopja e licencës, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Ndërsa për piken d, raportin mbi fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për tri vitet e fundit. Raporti duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, pozitën dhe vitin e punësimit

Eksperti shqyrtues vlerëson se ne bazë të nenit 26.8 te RRUOPP per kontrata te shërbimeve

d. Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore për secilin nga 3 vitet

d. Deklaratë të mesatares së fuqisëpunëtore të OE dhe numrin mesatarëtë stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet

Perkunder faktit se dëshmia e kërkuar ne dosjen e tenderit i referohet fuqisë mesatare punëtore në kërkesë nuk është reflektuar ndryshimi dhe prapë kërkohet numër i caktuar i te punësuarve (10 punrtorë). Ak ne këtë pikë ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e RRUOPP neni 26.8 pika d).

Lidhur me kërkesën e tillë KRRP – Departamenti i Monitorimit ka dërguar rekomandim per AK-në me datën 23.10.2023 me të cilin rekomandon riformulimin e kërkesës.

Ndersa sa i përket kërkesës për agronom dhe dy teknik sanitar eksperti shqyrtues vlerëson se i është dhënë sqarim në përgjigjen e kërkesës për sqarim të datës 25.10.2023. Për me tepër AK-ja u lejon qe këto pozita mund te angazhohen edhe me kontratë apo marrëveshje mbi angazhimin kështuqë vlerëson se kerkesa është në përputhje me nenin 7 te LPP-se dhe nenin 26.8 pika a) e RRUOPP. Sa i përket pretendimit te OE ankues mbi licencën dhe kush i licencon tekniket sanitar eksperti shqyrtues sqaron se me njoftimin mbi korrigjimin te datës 27.11.2023 nuk është e specifikuar se nga kush duhet te jenë te licencuar por që është kërkuar vetëm licence valide.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 6: *“Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me Aneksin 1 te dosjes se tenderit, specifikimin teknik eksperti shqyrtues sqaron se me formularin standard per korrigjimin e gabimeve te datës 27.11.2023 AK-ja ka bërë ndryshime nga kërkesat bazë të dosjes së tenderit në kërkesat si me poshtë:*

1. Dezinfektues: didecyldimethylammonium chloride 3.4gr, ose të ngjajshme);

2. Deratizues: (brodifacoum 0.005% ose bromodialon 0.005%); ose të ngjashme nga prodhues të ndryshëm por këto dy substanca

3. *Dezinsektues: (Bifenthrin 9,7 ose Fipronil 0.01 Yo ose Imidacloprid 10%; ose permethrine 30%, pyperonil butoxide 30%, ose të ngjashme nga prodhues të ndryshëm por këto tri substanca*

4. *Largimi izvarranikëve: Cinnamon oil ose vajra të ngjashme për këtë qëllim;*

OE ankues pretendimet e tij i ka per pozicionin 3. Bifenthrin 9,7 te cilin e përshkruan si i rrezikshëm dhe me mundësi që te kontaminojë gjallesat ujore, njerzit dhe kafshët. Eksperti shqyrtues sqaron se sipas kërkesës se specifikimit teknik në të gjithë dezinfektuesit është vendosur edhe fjala “ose” që i jep mundësi OE të zgjedhë ne mes të disa produkteve që përmbajnë këto preparate duke ju mundësuar OE –ve që të zgjedhin prodhuesin.

Sipas Nenit 19.6 te RRPP 001/2023 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “ose e barasvlerëshme/ekuivalente” .

AK-ja në këtë rast ju ka referuar përmbajtjes e jo prodhimit specifik prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se në këtë pikë pretendimi nuk është i qëndrueshëm. Sidoqoftë AK-ja duhet ta bëjë të qartë në dosje të tenderit përdorimin e fjalës “ose” a i lejon OE që të zgjedhin ne mes te produkteve me përmbajtje te ndryshme sikur e specifikuar ne dosje te tenderit.

Sa i perket dekalrimit te OE ankues se preparati duhet te perdoret me POWER SPRAYER eksperti shqyrtues ne dosjen e tenderit nuk ka mund te identifikojë kërkesë që i referohet se ndonjë preparat duhet të perdoret me nje pajisje specifike.

Sa i perket pretendimit per kërkesën dytë dhe të katërt për deratizues (brodifacoum 0.005% ose bromodialon 0.005%) dhe (Cinnamon oil ose vajra të ngjashme për këtë qëllim) OE ankues nuk e ka argumentuar se pse duhet të ndryshohet kërkesa dhe si rrjedhojë pretendimi nuk është i qëndrueshëm. Prandaj bazuar ne sqarimet e dhëna me lartë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K”- Prishtinë Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K”- Prishtinë janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që AK të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga ana e ekspertit në raportin e përgatitur lidhur për këtë aktivitet të prokurimit, vetëm në pikat për të cilat eksperti ka rekomanduar për ndryshime. Pra, Paneli Shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues duhet të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit si dhe duhet të ketë kujdes që në Dosjen e Tenderit mos të lejoj preparate të rrezikshme dhe të ndaluara me ligjet në fuqi dhe Rregullat Evropiane.

Lidhur me pohimin e ankuesit se AK ja ka përshtat specifikimet teknike vetëm të një prodhuesi atëherë paneli shqyrtues mendon se kjo paraqet shkelje të nenit 28 të LPP, kështu që AK është i obliguar që hartimin e Dosjes së Tenderit ta bëjë konform nenit 27 dhe 28 të LPP. Kështu që, AK duhet të ndërmarrë masa të verifikoj këto konstatime të OE ankues dhe nëse këto janë të qëndrueshme atëherë ti bëjë këto përmirësime. Deri në përfundim të këtij vlerësimi paneli shqyrtues erdhi si pasojë e mos konstatimit të saktë të gjendjes nga ana e ekspertëve shqyrtues. PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim dhe në paqëndrueshmëri dhe kundërshtim me dispozitat ligjore.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se ankesa është e bazuar, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK lidhur me atë nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 7, 27, 69 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme

dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: